

SUBJEKTE DEKLARUESE

Bazuar në nenin 3, të Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 "Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, lista e subjekteve që mbartin detyrim për deklarim të interesave private dhe pagat, paraqitet si në vijim:

Nr.	Institucioni	Funksioni	Kategoria e pagës
1 .	Komiteti Shqiptar I Birësimeve	Kryetar	II-1

1. Procedura e zgjedhjes

Mbështetur në nenin 6, të Ligjit nr.9695, datë 19.03.2007 "Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve", i ndryshuar, Kryetari i KSHB emerohet nga Kryeministri, me propozim të Ministrisë të Drejtësisë.

2. Kompetencat dhe detyrat

Mbështetur në nenin 11, të Ligjit nr.9695, datë 19.03.2007 "Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve", i ndryshuar, Kryetari i Komitetit drejton veprimtarinë e këshillit drejtues dhe të sekretariatit ekzekutiv dhe ka keto detyra:

- a) thërret këshillin drejtues në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme dhe përcakton rendin e ditës;
- b) drejton mbledhjet e këshillit drejtues;
- c) nënshkruan vendimet e marra në emër të këshillit drejtues dhe të institucionit që përfaqëson;
- ç) vërteton përputhjen e birësimit ndërvendas me dispozitat e konventës;
- d) nënshkruan marrëveshje me institucione analoge jashtë vendit, me agjenci vendase dhe të huaja, që ndërmjetësojnë në fushën e birësimit;
- dh) raporton për veprimtarinë e sekretariatit ekzekutiv përpara këshillit drejtues dhe për veprimtarinë e Komitetit përpara Ministrisë të Drejtësisë;
- e) përfaqëson Komitetin në marrëdhënie me institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit;
- ë) emëron ose largon nga detyra personelin e sekretariatit ekzekutiv, në përputhje me ligjin për statusin e nëpunësit civil dhe Kodin e Punës.